

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



ANNUAL REPORT

2011

RAPORT VJETOR

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



ANNUAL REPORT

2011

RAPORT VJETOR

CONTENTS

Message from the Chairman	6
AAB PROFILE	8
Albanian Banking System during 2011	12
Changes in the Banking Regulatory Framework	16
I. Regulations of Bank of Albania	16
II. Laws amendments affecting the Banking System	20
III. Other Legal Initiatives	24
Operational Activities	26
I. Cooperation and Initiatives	26
II. Advocacy and Supporting campaigns	30
III. Workshops & Trainings seminars	32
IV. AAB Publications	34
V. AAB Memberships	36
Member Banks	38
Selected Banking Sector and Macroeconomic Indicators	40
AAB Financial Activity	46

PËRMBAJTJA

Mesazh nga Kryetari	7
Profili i AAB-së	8
Sistemi Bankar Shqiptar gjatë viti 2011	13
Ndryshime ne Kuadrin Rregullator bankar	17
I.Rregulloret e Bankës së Shqipërisë	17
II. Ndryshime Ligjore që ndikojnë në sistemin bankar	21
III. Nisma të tjera ligjore	25
Aktivitetet Operacionale	27
I. Bashkëpunim dhe iniciativa	27
II. Promovimi dhe fushatat mbështetëse	31
III. Seminare dhe Trajnime	33
IV. Publikimet e AAB	35
V. Anëtarësimet e AAB	36
Bankat Anëtare	38
Disa Tregues Makroekonomikë dhe të Sistemit Bankar	40
Aktiviteti Financiar i AAB-së	46

MESSAGE FROM THE CHAIRMAN



Dear Colleagues:

Despite the slowdown and deleveraging in most of the world, the banking system in Albania continued to grow and has increased its lending to the economy in 2011. The ratio of banking assets to GDP increased from 80 per cent in 2010 to 85 per cent in 2011. The loans were up by 15 per cent, and the banks had more outlets and ATMs in 2011 than in 2010. Unfortunately, they had more problem loans, too, which reached some 20 per cent of the total. This is an alarming ratio, but it is in line with the other countries in the region. More importantly, it has not been increasing as fast as before, suggesting that the worst may be over.

Perhaps the most significant achievement of the Association in 2011 was the amendment of the Charter and changes to the membership fees. The former now is a guarantee that the elected Executive Committee will always be representative of the Assembly, while the latter ensures that there are enough funds available for the Association to undertake more meaningful tasks, which funds are contributed by the members as per their assets. Consequently, the net assets of the Association have gone up from Lek1.8 million in 2010 to Lek9.2 million in 2011.

The Association published its first periodical industry magazine in 2011. Bankieri, whose third issue has come out recently, already enjoys a wide readership not only among the bankers but also by the academicians and authorities, adding some flavour to our relationship with the latter.

The AAB continued to present and defend its opinion vis-à-vis the authorities, which opinion has been taken into account on many occasions. Unfortunately, the banking system's opinion fell on deaf ears in the cases of the liquidity and credit risk management regulations and was not even properly asked in the case of the amendments to the banking law. Granted that such regulatory action was in the context of a potentially deepening financial and economic crisis, but our opinion would have been constructive none the less.

In 2012, I would expect the AAB to be more active in organizing trainings and producing more positive publicity. We all need better bankers in the system as well as a better image in the public. Furthermore, we should continue the dialogue with the authorities so that loan collaterals are taken into account when assessing impairment and that they are executed faster.

In closing, I would like to thank the Secretariat and my fellow Executive Committee members for their contribution.

Kind regards,

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized first name followed by a surname and a large, sweeping flourish.

Seyhan PENCABLIGIL
Chairman

MESAZH NGA KRYETARI

Të dashur Kolegë:

Pavarësisht ngadalësimit të ekonomisë dhe uljes së huamarrjes në pjesën më të madhe të botës, sistemi bankar në Shqipëri vazhdoi të zhvillohej dhe e ka rritur huadhënien për sektorin e ekonomisë në vitin 2011. Raporti i asetëve bankare me PBB-në është rritur nga 80 për qind në vitin 2010 në 85 për qind në vitin 2011. Kreditë u rritën me 15 për qind dhe bankat kishin më shumë degë dhe ATM në vitin 2011 sesa në vitin 2010. Fatkeqësisht, ato patën edhe më shumë kredi me probleme, të cilat arritën në rreth 20 për qind të totalit të kredive. Ky është një raport alarmant, por është në të njëjtën linjë me vendet e tjera të rajonit. Për më tepër, rritja e tij është më e ulët se më parë, çka tregon se më e keqja mund të ketë kaluar.

Ndoshta arrijtjet më të rëndësishme të Shoqatës për vitin 2011 ishin amendimi që iu bë Statutit të saj dhe ndryshimet në kuotizacione. I pari tashmë garanton që Bordi Drejtues i zgjedhur do të jetë gjithmonë përfaqësues i Asamblesë, kurse ndryshimet në kuotizacione sigurojnë fonde të mjaftueshme që Shoqata të kryejë detyra më kuptimplote, fonde të cilat kontribuohen nga anëtarët në bazë të asetëve të tyre. Si rrjedhojë, asetet neto të Shoqatës janë rritur nga 1.8 milionë lekë në vitin 2010 në 9.2 milionë lekë në 2011.

Shoqata publikoi revistën e saj të parë bankare në vitin 2011. Bankieri, numri i tretë i të cilit doli së fundmi, tashmë ka një numër të gjerë lexuesish jo vetëm mes bankierësh, por edhe akademikësh dhe autoritetesh, duke i përmirësuar cilësisht marrëdhëniet tona me ta.

AAB vazhdoi të përfaqësojë dhe mbrojë mendimin e saj përballë autoriteteve, mendim i cili është marrë parasysh në shumë raste. Fatkeqësisht, opinioni i sistemit bankar ra në vesh të shurdhët në rastet e rregulloreve për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe kredisë, dhe as nuk u kërkua në rastin e ndryshimit të ligjit për bankat. Ne jemi të sigurt që këto veprime rregulluese u ndërmorën në kuadër të thellimit të mundshëm të krizës financiare dhe ekonomike, por opinioni ynë do të kishte qenë gjithsesi konstruktiv.

Në vitin 2012 unë pres që AAB të jetë më aktive në organizimin e trajnimeve dhe të prodhojë publicitet më pozitiv. Ne të gjithë kemi nevojë për bankierë më të mirë në sistem si dhe një imazh më të mirë në publik. Gjithashtu, ne duhet të vazhdojmë dialogun me autoritetet në mënyrë që kolateralët e kredive të merren parasysh kur vlerësohen dëmet dhe të mund ekzekutohen me shpejtësi.

Duke e mbyllur, dëshiroj të falënderoj Sekretariatit dhe kolegët e mi anëtarë të Bordit Drejtues për kontributin e tyre.

Përzemërsisht,



Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar




AAB PROFILE / PROFILI I AAB-SË



ORGANIZATIONAL CHART / STRUKTURA ORGANIZATIVE

AAB ASSEMBLY OF MEMBERS / ASAMBLEJA E ANËTARËVE



ORGANIZATIONAL CHANGES DURING 2011

NDRYSHIME ORGANIZATIVE GJATË VITIT 2011

AAB Assembly of Members held the Elections for the members of the Executive Committee and the Chairman of the Association in January 2011, electing as the new (current) Chairman Mr. Seyhan Pencabliligil, CEO and Board Member of Banka Kombëtare Tregtare.

Very important changes were made to the AAB Charter in the Assembly Meeting of May 2011, regarding both the funding and financing of the Association and the representation of banks in the Executive Committee.

The annual financial budget for the activities of AAB Secretariat for the period from 1 July 2011 until 31 June 2012 was doubled thanks to the increased membership fees that shall be now paid by banks in proportion to the percentage of their assets on the total assets of the banking system. Hence, the banks with higher share of assets have funded during the year most of the additional activities and accomplishments.

The changes to the AAB Charter have also stipulated that the Executive Committee is now composed by six members: three seats are reserved to the six banks with higher share of assets, and three seats to the ten remaining banks. Consequently, there is a broader and more consistent representation of all banks in the AAB Executive Committee.

One new technical Committee was established during year 2011, namely the Human Resources Committee aiming at working mainly on evidencing training needs of member banks' personnel and facilitating their organization, as well as sharing information on human resources better management.

Asambleja e Anëtarëve të AAB-së zhvilloi në janar 2011 zgjedhjet për anëtarët e Bordit Drejtues dhe Kryetarit të Shoqatës, duke zgjedhur në pozicionin e Kryetarit Z. Seyhan Pencabliligil, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare.

Në mbledhjen e Asamblesë në maj të vitit 2011 u miratuan ndryshime shumë të rëndësishme në Statutin e AAB-së, në lidhje me financimin e Shoqatës si dhe përfaqësimin e bankave në Bordin Drejtues.

Buxheti vjetor për aktivitetet e Sekretariatit të AAB-së, për periudhën nga 1 korrik 2011 deri në 30 qershor 2012, u dyfishua falë rritjes së kuotave të anëtarësimit që tani do të paguhen nga bankat në bazë të peshës së aktiveve të tyre në aktivet totale të sistemit bankar. Kështu, bankat me peshë më të madhe të aktiveve kanë financuar gjatë vitit pjesën më të madhe të aktiviteteve dhe arritjeve të shtuara.

Ndryshimet në Statutin e AAB-së përcaktojnë edhe përbërjen e Bordit Drejtues tashmë prej 6 anëtarësh: tre vende u rezervohen gjashtë bankave me peshë më të madhe të aktiveve, dhe tre vende dhjetë bankave të tjera. Në këtë mënyrë do të ketë një përfaqësim më të gjerë dhe më të plotë të të gjitha bankave në Bordin Drejtues të AAB-së.

Gjatë vitit 2011 u krijua një komitet i ri teknik, Komiteti i Burimeve Njerëzore, i cili do të synojë bashkërendimin e punës së përbashkët për të evidentuar nevojat për trajnim të punonjësve të bankave anëtare dhe për të lehtësuar organizimin e tyre, si dhe shkëmbimin e informacionit mbi administrimin më të mirë të burimeve njerëzore.



AAB EXECUTIVE COMMITTEE / BORDI DREJTUES I AAB-SË

(AS OF JUNE 2012)

(NË FUND TË QERSHORIT 2012)



Mr. Seyhan PENCABLIGIL
Chief Executive Officer / Drejtor i Përgjithshëm
BANKA KOMBËTARE TREGTARE
Chairman / Kryetar



Mr. Ioannis KOUGIONAS
General Manager / Drejtor i Përgjithshëm
NATIONAL BANK OF GREECE - ALBANIA
Deputy Chairman / Zëvendës Kryetar



Mr. Christian CANACARIS
Chief Executive Officer
Drejtor i Përgjithshëm,
RAIFFEISEN BANK - ALBANIA
Member / Anëtar



Mr. Periklis DROUGKAS
Country Manager / Drejtor i
Përgjithshëm
ALPHA BANK - ALBANIA
Member / Anëtar



Mr. Bozhidar TODOROV
General Director
Drejtor i Përgjithshëm
FIRST INVESTMENT
BANK - ALBANIA
Member / Anëtar



Ms. Flutura VEIPI
Spokesperson of Management Board
Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive
PROCREDIT BANK - ALBANIA
Member / Anëtare

AAB SECRETARIAT / SEKRETARIATI I AAB-SË



Ms. Endrita XHAFERAJ
Secretary General
Sekretare e Përgjithshme



Ms. Brunilda KOSTARE
Legal Adviser
Këshilltare Ligjore



Ms. Junida KATROSHI
Operations Specialist
Specialiste e Operacioneve



Ms. Marsela BULKU
Administrative assistant
Asistente administrative

ALBANIAN BANKING SYSTEM DURING 2011

The crisis proved that the banking system in Albania, as in several other countries of Central and Eastern Europe has had a stabilising character, rather than an accelerating one.

The Albanian economy was one of the few economies in south-eastern Europe that did not experience recession despite the global crises and its spillover into Europe. However, the pace of growth has decelerated, and the slow-down is more evident in 2011, reflecting in particular the weakening performance in the neighbour EU countries.

The banking sector has so far remained resilient to the crisis and private sector credit growth has resumed in the past year. In fact the crisis proved that the banking system in Albania, as in several other countries of Central and Eastern Europe have had a stabilising character, rather than an accelerating one, as was thought in the initial stages of the crisis. Nevertheless, weak domestic demand and a slowing external background are weighing on the growth outlook, with the ratio of nonperforming loans as the main challenge.

At the end of 2011, the Albanian banking sector continued to be composed by 16 commercial banks totally privately owned, with around 92 percent of the total assets invested by foreign capital.

The assets of the banking system increased at a higher pace in 2011 both in nominal terms (by 13.1 percent) and as contribution to the Gross Domestic Product (reaching 85 percent), indicating a stronger intermediation activity of the banking sector. The deposits had during year 2011 an important increase of 13.1 percent, mainly as a result of the increase of retail deposits, thus reflecting the orientation of customers towards savings and the strengthening of their confidence in the banking sector.

Despite the challenges of the low domestic demand and the tightening of crediting conditions, the loan portfolio of banks increased during 2011 by 15.3%, with a rising tendency throughout the quarters. The growth was mainly driven by lending to

the corporate sector, and quite more evident in loans given in domestic currency. The loan-to-deposit ratio remained at the end of 2011 at around 61 percent, indicating that the banking system is less dependent on external financing, and has sufficient capacities to grow.

The maturity structure of new loans issued in 2011 shows that banks are mainly focused on short term lending (with 63 percent of the total new loans), reflecting also the domestic economy's need for immediate liquidity.

The level of non-performing loans reached 18.8% in December 2011, affected not only by the difficulties in several sectors of the economy, but also by the slowdown in credit growth rates in the last 2-3 years.

Due to the increase of nonperforming loans and in compliance with the regulatory requirements of Bank of Albania, banks have increased their provisioning funds, significantly affecting the net result of the banking activity and the profitability indicators of the system, that was lower compared with the previous quarter, albeit the net result of the system for the year subsisted at a positive figure.

The banking activity expanded and was reorganized during 2011 in terms of opening new branches and agencies and closing some of the existing ones. The total number of outlets and agencies reached 552 (compared to 548 in December 2010).

In addition, banks have reached closer to their customers by enhancing the financial infrastructure through the deployment in the country of 34 new ATMs and 223 new POSes throughout the year. Usage of credit and debit cards has increased over the year, in response not only to the better acquaintance of the public in this regards, but also as a result of the policies of banks to reduce maintenance and usage costs of these cards.

SISTEMI BANKAR SHQIPTAR GJATË VITIT 2011

Ekonomia shqiptare ishte një prej ekonomive të pakta në Evropën juglindore e cila nuk përjetoi rënie pavarësisht krizës globale dhe përhapjes së saj në Evropë. Megjithatë, ritmi i rritjes është ulur, dhe ngadalësimi është më i dukshëm në vitin 2011, duke pasqyruar sidomos dobësimin e ecurisë së vendeve fqinje anëtare të BE-së.

Deri më tani sektori bankar i ka bërë ballë krizës dhe rritja e kredisë për sektorin privat u rikthye sërish vitin e kaluar. Në fakt, kriza provoi se sistemi bankar në Shqipëri, ashtu si dhe në disa vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, ka pasur një karakter stabilizues dhe jo përshpejtues, siç u mendua në fazat fillestare të krizës. Megjithatë, kërkesa e dobët e brendshme dhe një situatë e jashtme në ngadalësim po rëndojnë mbi parashikimet për rritje, duke evidentuar si sfida kryesore raportin e kredive me probleme.

Në fund të vitit 2011 sektori bankar shqiptar vazhdoi të përbëhej nga 16 banka tregtare tërësisht nën pronësi private, me rreth 92 për qind të aktiveve totale të investuara nga kapital i huaj.

Aktivitetet e sistemit bankar u rritën me një ritëm më të lartë në 2011, si në terma nominale (me 13.1 për qind) ashtu edhe si kontribut ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (duke arritur 85 për qind), gjë që tregon një veprimtari më të fortë ndërmjetësuese të sektorit bankar. Gjatë vitit 2011 depozitat patën një rritje të rëndësishme prej 13.1 për qind, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të individëve, duke pasqyruar kështu orientimin e klientëve drejt kursimit dhe forcimin e besimit të tyre tek sektori bankar.

Pavarësisht sfidave të kërkesës së brendshme në ulje dhe shtrëngimit të kushteve për kredidhënie, portofoli i kredive i bankave në vitin 2011 u rrit me 15.3 për qind, me prirje rritëse përgjatë tremujorëve. Rritja u mundësua kryesisht nga dhënia e kredive për sektorin privat, dhe ishte më e dukshme në kreditë e dhëna

në valutë vendase. Raporti kredi-depozita në fund të vitit 2011 qëndroi rreth 61 për qind, duke treguar se sistemi bankar është më pak i varur nga financimet e jashtme dhe ka kapacitete të mjaftueshme për tu zhvilluar.

Struktura e maturimit të kredive të reja të dhëna në vitin 2011 tregon se bankat kryesisht janë përqendruar në huadhënien afatshkurtër (me 63 për qind të totalit të kredive të reja), si dhe pasqyron nevojën e ekonomisë vendase për likuiditet të menjëhershëm.

Niveli i kredive me probleme arriti në 18.8 për qind në dhjetor 2011, ndikuar jo vetëm nga vështirësitë në disa sektorë të ekonomisë, por edhe nga ngadalësimi i ritmeve të rritjes së kredive në 2-3 vitet e fundit.

Si rezultat i rritjes së kredive me probleme, dhe në përputhje me kriteret normuese të Bankës së Shqipërisë, bankat rritën provigjionet e tyre, çka ka ndikuar dukshëm në rezultatin neto të veprimtarisë bankare dhe treguesit e përfitueshmërisë së sistemit, të cilët kanë qenë më të ulët në krahasim me tremujorin e mëparshëm, pavarësisht se rezultati neto i sistemit për të gjithë vitin qëndroi në shifra pozitive.

Veprimtaria bankare në vitin 2011 u zgjerua dhe u ri-organizua me hapjen e degëve dhe agjencive të reja dhe mbylljen e disa ekzistueseve. Numri i përgjithshëm i degëve dhe agjencive arriti në 552 (krahasuar me 548 në dhjetor të vitit 2010).

Gjithashtu, bankat u janë afruar më shumë klientëve të tyre duke përmirësuar infrastrukturën financiare nëpërmjet instalimit të 34 ATM-ve të reja dhe 223 POS-ve të reja në të gjithë vendin gjatë vitit 2011. Përdorimi i kartave të debitit dhe kreditit është rritur gjatë vitit, si rrjedhojë jo vetëm e njohjes më të mirë nga publiku, por edhe e politikave që bankat kanë përdorur për të ulur kostot e mirëmbajtjes dhe përdorimit të këtyre kartave.

Kriza provoi se sistemi bankar në Shqipëri, ashtu si dhe në disa vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, ka pasur një karakter stabilizues dhe jo përshpejtues.



Table 1. Performance indicators of Albanian Banking System / Tabela 1. Tregues të performancës së Sistemit Bankar Shqiptar

Indicator	Tregues	2009	2010	2011
Total assets (billion ALL)	Aktivet në total (miliardë lekë)	886.3	990.6	1,120.2
in % of GDP	në për qind të PBB	77.5 %	79.7%	84.6%
Total Deposits (billion ALL)	Depozitat në total (miliardë lekë)	694.3	816.7	924.1
in % of GDP	në për qind të PBB	60.7%	65.7%	69.8%
Credit to Economy (billion ALL)	Kredia për ekonominë (miliardë lekë)	449.4	490.9	566.2
in % of GDP	në për qind të PBB	39.3%	39.5%	42.8%
Shareholders' Equity (billion ALL)	Kapitali i Aksionarëve (miliardë lekë)	84.8	93.1	97.3

Source: Bank of Albania / Burim: Banka e Shqipërisë

Table 2. Network of Banks / Tabela 2. Rrjeti i bankave

Indicator	Tregues	2010	2011
No. of Outlets	Numri i degëve	548	552
No. of ATM	Numri i ATM-ve	771	805
No. of POS	Numri i pikave të shitjes (POS)	4,903	5,126
No. of Cards	Numri i kartave	694,848	731,851
- debit	- debiti	667,548	693,958
- credit	- krediti	27,300	37,893

Source: Bank of Albania, AAB / Burim: Banka e Shqipërisë, AAB

CHANGES IN THE BANKING REGULATORY FRAMEWORK

I. REGULATIONS OF BANK OF ALBANIA

I. ON MANAGEMENT OF OPERATIONAL RISK

The Regulation “On management of operational risk” was approved by the Supervisory Council of Bank of Albania on January 2011. Through this regulation Bank of Albania (BoA) has set out the rules and requirements for the management of operational risk in the banking and financial activity. According to this regulation banks should set up internal systems consisting of policies, procedures, rules and techniques, in order to ensure an efficient management of operational risk.

AAB Secretariat organized in August 2011 a meeting of representatives from banks and BoA, to discuss on the main implications of the implementation of such regulation in the banking activity. In this meeting participants discussed and clarified particular issues set by the regulation such as: the classification of the supporting or secondary processes in the bank and the annual reporting of banks losses according to their business lines; the items to be included in the costs of court processes as one of the main indicators of operational risk; the definition of an indicating list of adequate indicators ensuring an earlier warning of the increase of the operational risk; clarifications regarding tools or programs banks should use to decrease the exposure towards the events that can have a big impact in their financial results, etc..

II. ON CREDIT RISK MANAGEMENT

By February 2011 BoA had sent for comments to all banks the draft Regulation on Credit Risk Management, with revisions to almost all items of the existing one. The purpose of this draft Regulation was to lay out the rules and requirements for credit risk management in banks’ activity, and the criteria for the assessment of risk and classification of loans and other assets, and for the calculation of reserves for loan losses.

Considering the importance of such Regulation, AAB Secretariat organized a meeting with all banks’ representatives, in order to discuss on further possible and necessary improvements to the regulation, followed up by a comprehensive material with comments and suggestions sent to BoA. In general, banks had objections on the changes in the draft regulation, mainly related to the fact that instead of providing convergence of local and international standards in loans classification and provisioning, as previously discussed in forums the BoA and commercial banks, this draft regulation increased the actual gap. Banks objected also that by introducing the concept of guarantees/collateral as an element of loan loss mitigation does not provide the required impact if limited only to financial collateral and guarantees, without taking into account real estate collaterals, that guarantee the majority of loans granted by commercial banks.

Nevertheless and unfortunately, the original draft of the regulation was approved from the Supervisory Council of BoA on 14.09.2011, and almost none of the banks’ suggestions were taken into consideration.



NDRYSHIME NË KUADRIN RREGULLATOR BANKAR

I. RREGULLORET E BANKËS SË SHQIPËRISË

I. PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL

Rregullorja “Për administrimin e rrezikut operacional” u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në janar 2011. Nëpërmjet kësaj rregulloreje Banka e Shqipërisë (BSh) ka parashikuar rregulla dhe detyrime për administrimin e rrezikut operacional në veprimtaritë bankare dhe financiare. Sipas kësaj rregulloreje, bankat duhet të ndërtojnë sisteme të brendshme që përfshijnë politika, procedura, rregulla dhe teknika me qëllim sigurimin e një administrimi efikas të rrezikut operacional.

Në gusht 2011 Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me përfaqësues nga bankat dhe BSh për të diskutuar mbi pasojat kryesore të zbatimit të kësaj rregulloreje në veprimtarinë bankare. Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit diskutuan dhe sqaruan disa çështje specifike të parashikuara nga rregullorja, si: klasifikimi i proceseve mbështetëse apo dytësore në bankë dhe raportimi vjetor i humbjeve të bankave në përputhje me linjat e tyre të biznesit; zërat që duhen përfshirë në kostot e proceseve gjyqësore si një prej treguesve kryesorë të rrezikut operacional; hartimi i një liste me tregues të mjaftueshëm që paralajmërojnë në kohë në rastin e rritjes së rrezikut operacional; sqarime në lidhje me instrumentet apo programet që duhen përdorur nga bankat për të ulur ekspozimin ndaj ngjarjeve që mund të kenë ndikime të mëdha në rezultatet e tyre financiare, etj.

II. PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

Brenda muajit shkurt 2011 BSh u kishte dërguar të gjitha bankave për komente projekt rregulloren mbi administrimin e rrezikut të kredisë, e cila kishte rishikime të pothuajse të gjitha pikave të rregullores ekzistuese. Qëllimi i kësaj projekt-rregulloreje ishte parashtrimi i rregullave dhe detyrimeve për administrimin e rrezikut të huadhënies në veprimtaritë bankare, kriteret për vlerësimin e rrezikut dhe klasifikimin e huave dhe aktiveve të tjera, si dhe për llogaritjen e rezervave për humbjet e huave.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj rregulloreje, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me përfaqësues të të gjitha bankave, për të diskutuar mbi përmirësimet të tjera të mundshme dhe të nevojshme të saj. Ky takim u ndoq nga një material gjithëpërfshirës me komente dhe sugjerime, i cili iu dërgua BSh-së. Në përgjithësi, bankat kishin vërejtje për ndryshimet në projekt-rregullore, kryesisht në lidhje me faktin se në vend që të siguronte harmoni mes standardeve vendase dhe ndërkombëtare në klasifikimin e huave dhe provigjionet, siç ishte diskutuar më parë në disa forume mes BSh dhe bankave tregtare, kjo projekt-rregullore e zgjeronte ndarjen ekzistuese. Gjithashtu, bankat argumentuan se vetëm futja e konceptit të garancive/kolateralit si element për zbutjen e humbjes së huave nuk jep ndikimin e duhur nëse do të kufizohet vetëm në kolaterale dhe garanci financiare, pa marrë parasysh edhe kolateralit në formën e pronave të paluajtshme, të cilat garantojnë pjesën më të madhe të huave të dhëna nga bankat tregtare.

Megjithatë dhe fatkeqësisht, Këshilli Mbikëqyrës i BSh-së miratoi projektin fillestar të rregullores më 14 shtator 2011, dhe pothuajse asnjë nga sugjerimet e bankave nuk u mor parasysh.



I. REGULATIONS OF BANK OF ALBANIA (continued)

III. ON THE MINIMUM REQUIRED RESERVE HELD BY BANKS WITH BANK OF ALBANIA

On April 2011, the Supervisory Council of the BoA approved the Decision "On some amendments to the Regulation "On the Minimum Required Reserve Held by Banks with the BoA". According to these amendments BoA may remunerate banks for the required reserve they hold in Lek or in foreign currency, for the period it is held, but it does not have to do so in any case, as was stipulated in the earlier version of the regulation. The regulation also foresees that in case of remuneration the remuneration rate is determined by the Supervisory Council decision and it is disclosed at least 30 business days prior to the beginning of the holding period.

IV. ON THE CAPITAL ADEQUACY RATIO

On 14 September 2011, the Supervisory Council of Bank of Albania adopted the Decision No. 63 "On some Amendments to Regulation "On Capital Adequacy Ratio"". The amendments in this Decision affect Article 8 of this Regulation, which regulate the risk-weighting of assets in the balance sheet.

Thus, the amendments stipulate that the loans granted and/or indexed in foreign currency to non residents shall be weighted with 150% risk instead of 100 % as in the existing regulation. Likewise, an amendment is made for loans granted outside the territory where the banks' activity is based, which shall be weighted with 150% risk.

In addition, some amendments and simplifications have been made to the calculation method for several other items in the balance sheet to be weighted with 150 % risk.

V. ON LIQUIDITY RISK MANAGEMENT

Since July 2011, BoA had informed banks on eventual measures related to the liquidity risk and its management, and on the intention to introduce possible regulative amendments on the quantitative requirements for liquidity risk management, with the aim of improving qualitatively the liquidity situation and risk management.

AAB on behalf of the banks has continuously expressed the need to carefully consider the implementation timelines for the full introduction of the new approach, leaving banks an appropriate transition time to undertake the necessary processes for adoption, as well as their positioning regarding quantitative ratios, rating of investment securities, and especially regarding the utmost need for further consultation with banks in such regards.

In October 2011 BoA communicated the changes to the regulation "On Liquidity Risk Management" which were eventually approved by the Supervisory Council of BoA on 26 October 2011, and which realised in practice what had been earlier announced both in terms of qualitative and quantitative measures. Important amendments to the regulation that impact significantly banks' activities, focused on: the liquidity indicator; the liquid assets composition; and the identification of items to be considered as highly liquid within the liquid assets structure. One of the innovations of the regulation was the detailed definition of the liquid assets and the application of the concept of the tradable bonds counterparty evaluation. There were also some additional changes concerning the reporting frequency on the new indicators and their application.

I. RREGULLORET E BANKËS SË SHQIPËRISË (vazhdon)

III. PËR MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUESHME QË MBAJNË BANKAT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në prill 2011 Këshilli Mbikëqyrës i BSh miratoi vendimin “Për disa ndryshime në Rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyrueshme që mbajnë bankat në Bankën e Shqipërisë”. Sipas këtyre amendimeve, BSh mund të remunerojë bankat për rezervën e detyrueshme që ato mbajnë në lekë apo valutë të huaj, për periudhën që mbahet, por nuk e ka si detyrim për çdo rast, siç ishte në versionin e mëparshëm të rregullores. Gjithashtu, rregullorja parashikon se në rast remunerimi, masa e tij përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe publikohet të paktën 30 ditë pune përpara fillimit të periudhës së llogaritjes.

IV. PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

Në 14 shtator 2011. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Vendimin nr. 63 “Për disa ndryshime në Rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”. Ndryshimet në këtë vendim prekin Nenin 8 të kësaj Rregulloreje, i cili normon vlerësimin e rrezikut të aseteve në bilanc.

Pra, në bazë të këtyre ndryshimeve kreditë e dhëna dhe/ose indeksuara në valutë të huaj ndaj personave jo rezidentë do të vlerësohen me 150 për qind rrezik dhe jo 100 për qind si në rregulloren ekzistuese. Gjithashtu, u bë dhe një ndryshim për kreditë e dhëna jashtë territorit ku kryhet veprimtaria e bankave, të cilat do të vlerësohen me 150 për qind të rrezikut.

Disa ndryshime dhe thjeshtime u ndërmorrën edhe përsa i përket metodës së llogaritjes së disa zërave të tjerë në bilanc, të cilat do të vlerësohen me 150 për qind rrezik.

V. PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT

Që në korrik 2011 BSh pati informuar bankat mbi disa masa eventuale në lidhje me rrezikun e likuiditetit dhe administrimin e tij, si dhe mbi planet për të ndërmarrë masa rregullative me karakter sasior në lidhje me administrimin e rrezikut të likuiditetit, me qëllim përmirësimin cilësor të situatës së likuiditetit dhe administrimit të rrezikut.

AAB, në emër të bankave ka shprehur vazhdimisht nevojën për të shqyrtuar me kujdes afatet kohore për zbatimin e plotë të kësaj qasjeje të re, në mënyrë që bankave tu jepet një kohë e mjaftueshme tranzicioni për të ndërmarrë të gjitha proceset e nevojshme për përshtatje. Gjithashtu, ka shprehur edhe pozicionimin e bankave në lidhje me raportet sasiore, vlerësimin e investimeve në letra me vlerë, dhe sidomos nevojën e madhe për konsultim të mëtejshëm me bankat për këto çështje.

Në tetor 2011 BSh komunikoi ndryshimet në rregulloren “Për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit”, të cilat u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i BSh-së më 26 tetor 2011, dhe të cilat bënë realitet ato çka ishte paralajmëruar më herët parë në lidhje me masat cilësore dhe sasiore.

Ndryshimet e rëndësishme në rregullore, të cilat ndikuan dukshëm në veprimtaritë e bankave, përqendroheshin në: treguesin e likuiditetit; përbërjen e aktiveve likuide; identifikimin e zërave që duhen konsideruar si shumë likuide, brenda strukturës së aktiveve likuide. Një prej risive të kësaj rregulloreje ishte përkufizimi i hollësishtëm i aktiveve likuide dhe përdorimi i konceptit të vlerësimit të kundërpartisë së obligacioneve të tregtueshme. Pati edhe disa ndryshime në lidhje me shpeshhtësinë e raportimit mbi treguesit e rinj dhe aplikimin e tyre.





II. LAW AMENDMENTS AFFECTING THE BANKING SYSTEM

I. LAW ON BANKS

The amendments on the Law “On Banks in the Republic of Albania” prepared by BoA and approved by the Parliament in 17 November 2011, aimed at further approximation with EU directives in the field of banking and financial services, as well as with standards and international best practices in the field of handling and resolving banks problems.

These changes consist mainly in redefining the banking activity through:

- Defining Electronic Money and Electronic Money Institutions, removing the exclusive right of banking entities to issue means of payment in the form of electronic money; excluding from the prohibition of accepting deposits entities that receive monetary fund’s versus immediate issue of electronic money, reflecting thus the EU Directive 2009/110/EC;
- Defining systemic risk as the risk associated with factors that might threaten stability, the value of assets and/or confidence in the banking system or the financial market in general;
- Stipulating the possibility of conversion of branches of foreign banks into Albanian subsidiaries functioning as commercial companies and subsidiaries of foreign banks. Such conversion can be obligatory when deemed necessary by BoA on the grounds of systemic risk management;
- Foreseeing the notion of the “bridge bank”, as a temporary solution opportunity / technique for a troubled bank, enabling the latter to continue its operations until finding a permanent solution.

Granted that the scope of these changes was to preserve and ensure the stability of the banking system, the draft law passed and was approved by the Parliament promptly, leaving no space to consultations with the banking system.

II. LAW ON REGISTRATION IMMOVABLE PROPERTIES

The Albanian Association of Banks was part of the consultation process of amending the Law “On registration of immovable properties”, during October - November 2011. In this regards, the Chairman and Secretary General of AAB as well as the members of the AAB Legal Committee participated in October in a roundtable organized by the Ministry of Justice, in order to discuss the new draft.

Following this event, the AAB Legal Committee gathered and discussed on the comments of the banking system regarding such draft law, which after consultation were sent to the Ministry of Justice. Many of the concerns and suggestions were taken into consideration from the Ministry, such as on issues related to the fund of guarantee, the blocking (suspension) procedure, and the legal mortgage.

In 21 March 2012, the Albanian Parliament approved the new Law which brings some substantial improvements in the functionality of the Office for Registration of Immovable Properties, by guaranteeing judicial security and transparency in the overall activity of the most important institution, regarding the immovable properties. The law regulates, in a more precise and practical way, as compared to the old law, data guarantee contained in the registers of immovable properties, as well as the security of property and the owner’s or third parties’ respective real rights.

The law provides also for the first time, public and private subjects, with the opportunity to consult the electronic register of immovable properties. This would definitely produce practical advantages for banks, by shortening the time factor, and ensuring better human resources management in the course of conducting preliminary verifications, related to loan-making process.

II. NDRYSHIME LIGJORE QË NDIKOJNË NË SISTEMIN BANKAR

I. LIGJI PËR BANKAT

Ndryshimet në Ligjin “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, hartuar nga BSh dhe miratuar nga Parlamenti më 17 nëntor 2011, kishin si synim përaftrimin me direktivat e BE-së mbi shërbimet bankare e financiare, dhe me standardet e praktikat më të mira ndërkombëtare të trajtimit dhe administrimit të bankave me probleme.

Këto ndryshime konsistojnë kryesisht në rিপrecaktimin e veprimtarive bankare nëpërmjet:

- Përkufizimit të Parasë Elektronike dhe Institucioneve të Parasë Elektronike, duke u hequr ekskluzivitetin bankave për emetimin e mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike; duke shtuar ndër subjektet që mund të pranojnë depozita subjekte të cilat pranojnë fonde monetare përkundrejt emetimit të menjëhershëm të parasë elektronike, duke reflektuar kështu Direktivën e BE-së 2009/110/EC;
- Përkufizimit të rrezikut sistematik si rrezik i lidhur me faktorë që mund të kërcënojnë stabilitetin, vlerën e aktiveve dhe/ose besimin në sistemin bankar apo tregun financiar në përgjithësi;
- Parashikimit të mundësisë së shndërrimit të degëve të bankave të huaja në filiale shqiptare, të organizuara si shoqëri tregtare dhe filiale të bankave të huaja. Një shndërrim i tillë mund të jetë i detyruar sa herë të shihet e nevojshme nga BSh për shkaqe të administrimit të rrezikut sistematik;
- Parashikimit të nocionit të “bankës urë”, si një mundësi/teknikë zgjidhjeje të përkohshme për një bankë në vështirësi, që do ta lejonte këtë të fundit të vazhdonte veprimtaritë e saj derisa të gjendej një zgjidhje e përhershme.

Synimi i këtyre ndryshimeve ishte sigurisht ruajtja dhe garantimi i stabilitetit të sistemit bankar, por projektligji u kalua dhe miratua nga Parlamenti shumë shpejt, pa lënë vend për konsultime me sistemin bankar.

II. LIGJI PËR REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME


Shoqata Shqiptare e Bankave u bë pjesë e procesit të konsultimit për ndryshimin e Ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, gjatë periudhës tetor-nëntor 2011. Në këtë kuadër, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB si dhe anëtarët e Komitetit Ligjor të AAB morën pjesë në tetor në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga Ministria e Drejtësisë me qëllim diskutimin e projektligjit të ri.

Pas këtij takimi, Komiteti Ligjor i AAB u mblodh dhe diskutoi komentet e sistemit bankar mbi këtë projektligj, të cilat pas konsultimeve iu dërguan Ministrisë së Drejtësisë. Shumë prej shqetësimeve dhe sugjerimeve u morën në konsideratë nga kjo Ministri, si p.sh. ato në lidhje me fondin e garancisë, procedurën e bllokimit (pezullimit) si dhe hipotekën ligjore.

Në 21 mars 2012 Parlamenti shqiptar miratoi ligjin e ri, i cili sjell disa përmirësime të dukshme në funksionalitetin e Zyrës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, duke garantuar siguri gjyqësore dhe transparencë në veprimtarinë e përgjithshme të institucionit më të rëndësishëm në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Ligji rregullon në një mënyrë më precize dhe praktike se ligji i vjetër, garancinë e të dhënave të përfshira në regjistrat e pasurive të paluajtshme si dhe sigurinë e pronës dhe të drejtat reale përkatëse të pronarit apo palëve të treta.

Gjithashtu, për herë të parë ky ligj u jep subjekteve publike dhe private mundësinë për tu konsultuar me regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme. Kjo padyshim do të sjellë avantazhe praktike për bankat duke shkurtuar faktorin kohë dhe duke siguruar administrim më të mirë të burimeve njerëzore gjatë kryerjes së verifikimeve paraprake në lidhje me procesin e dhënies së kredive.





II. LAW AMENDMENTS AFFECTING THE BANKING SYSTEM (continued)

III. LAW ON ANTI MONEY LAUNDERING AND TERRORIST FINANCING

On March 2011 the Parliament approved the Law “On some amendments to Law no. 9917 dated 19.05.2008 “On prevention of money laundering and terrorist financing”.

AAB has been part of the consultation process, and has discussed the draft law in its technical committees and presented the relevant comments and suggestions to the Responsible Authority. Some important banks’ comments and suggestions were taken into consideration.

The amendments mainly consist in the extension of the measures to be taken from the subjects of this law regarding the enhanced due diligence; in the amendments of administrative sanctions aiming to set up fixed sanctions by foreseeing a minimum and maximum amount in difference from the existing one (the sanctions were foreseen on percentages of the non reported transactions); in the protection of the identity of the reporting entities of this law.

II. NDRYSHIME LIGJORE QË NDIKOJNË NË SISTEMIN BANKAR (vazhdon)

III. LIGJI PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT

Në mars 2011 Parlamenti miratoi Ligjin “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9917 të datës 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”.

AAB ishte pjesë e procesit të konsultimit dhe projektligji u diskutua në disa nga komitetet e saj teknike, duke i paraqitur Autoritetit Përgjegjës komentet dhe sugjerimet përkatëse. Disa komente dhe sugjerime të rëndësishme të bankave u morën në konsideratë.

Ndryshimet konsistojnë kryesisht në shtimin e masave që duhen të merren nga subjektet e këtij ligji në lidhje me vigjilencën e thelluar; në ndryshime të sanksioneve administrative që synojnë caktimin e sanksioneve fikse, duke parashikuar një sasi minimale dhe maksimale, ndryshe nga ato ekzistuese (sanksionet përcaktoheshin si përqindje të transaksioneve të pa-raportuara); në mbrojtjen e identitetit të enteve raportuese në kuadër të këtij ligji.





III. OTHER LEGAL INITIATIVES

I. PROPOSAL FOR THE CIVIL PROCEDURES CODE

In light of the concerns of banks and the difficulties faced by them in the process of collateral enforcement, AAB Secretariat organized several meetings and roundtables during the second half of the year, both with AAB Legal Committee members and with other parties such as Bank of Albania, Ministry of Finance, the Supreme Court, General Directory of Bailiff, Private Bailiff, and representatives of two donors' projects in Albania involved in this field GIZ and USAID.

One of the main topics of discussion was that on the necessary changes in the Civil Procedure Code, aiming improvement of the execution process. The AAB Legal Committee sorted out the main necessary amendments and prepared a thorough list-material.

In this context AAB Secretariat had two meetings during August and September with the representatives of EURALIUS (an EU project assisting the Ministry of Justice in converging the legislative framework to the EU standards) who have included most of bank's proposals for changes to the Code of Civil Procedure relating to compulsory execution procedures, in their recommendations to the Ministry of Justice.

II. LAW ON FISCAL AMNESTY AND CAPITAL LEGALISATION

By May 2011, the Ministry of Finance had issued a Guideline on assets and capital legalization for the implementation of the Law on Fiscal Amnesty, which regarded banks especially in the part of procedures to be followed by customers. To clarify issues the procedures for banks' staff on the proper implementation of the Guideline when dealing with customers' applications, AAB organized a meeting in June 2011 with representatives from the Ministry of Finance and BoA. Subsequently, based on discussions at that meeting, AAB required some amendments to the Guideline regarding the documentations to be required by customers, but more importantly, regarding the limitation of the responsibilities of banks in the entire legalization process. Such amendments were taken into consideration and reflected in the revised Guideline, and a further Workshop was organized by AAB with the purpose of informing banks' personnel about the operational procedures to follow with customers for the better performance of the whole process.

III. NISMA TË TJERA LIGJORE

I. PROPOZIM PËR KODIN E PROCEDURËS CIVILE

Si rrjedhojë e problematikave dhe vështirësive me të cilat përballen bankat gjatë procesit të ekzekutimit të kolateralëve, Sekretariati i AAB-së organizoi disa takime dhe tryeza të rrumbullakëta gjatë gjysmës së dytë të vitit, si me anëtarë të Komitetit Ligjor të AAB ashtu dhe me palë të tjera si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Gjykata e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit, Përbarues Privatë dhe përfaqësues të dy projekteve donatore në Shqipëri të përfshira në këtë fushë, GIZ dhe USAID.

Një prej temave kryesore të diskutimit ishte ai mbi ndryshimet e nevojshme në Kodin e Procedurës Civile, me synim përmirësimin e procesit të ekzekutimit. Komiteti Ligjor i AAB renditi ndryshimet kryesore të nevojshme dhe përgatiti një material me një listë të plotë.

Në këtë kuadër Sekretariati i AAB-së pati dy takime gjatë muajve gusht dhe shtator me përfaqësues të EURALIUS (një projekt i BE-së që asiston Ministrinë e Drejtësisë në përafrimin e kuartrit ligjor me standardet e BE-së), të cilët përfshinë në rekomandimet e tyre për Ministrinë e Drejtësisë pjesën më të madhe të propozimeve të bankave për ndryshime të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me procedurat për ekzekutim të detyruar.

II. LIGJI PËR AMNISTINË FISKALE DHE LEGALIZIMI I KAPITALIT

Brenda muajit maj 2011, Ministria e Financave nxori një Udhëzues mbi legalizimin e kapitalit në zbatim të Ligjit për Amnistinë Fiskale, i cili implikonte kryesisht bankat, sidomos në atë pjesë të procedurave që duheshin ndjekur nga klientët. Për të sqaruar personelin bankar në lidhje me procedurat për një zbatim të mirë të Udhëzuesit gjatë trajtimit të aplikimeve të klientëve, AAB organizoi një takim në qershor 2011 me përfaqësues nga Ministria e Financave dhe BSh. Në vijim, bazuar në diskutimet gjatë takimit, AAB kërkoi të bëheshin disa ndryshime në Udhëzues në lidhje me dokumentacionin që u kërkohet klientëve, dhe çka ishte më e rëndësishme, në lidhje me kufizimin e përgjegjësive të bankave në tërësinë e procesit të legalizimit. Këto ndryshime u morën në konsideratë dhe u pasqyruan në Udhëzuesin e rishikuar. Më tej AAB organizoi një seminar me qëllim informimin e personelit të bankave mbi procedurat operacionale për të siguruar një ecuri më të mirë të gjithë procesit.



Workshop regarding the implementation of the Law on Fiscal Amnesty, organized by AAB on 23 June 2011.

Takimi mbi zbatimin e Ligjit për Amnistinë Fiskale, organizuar nga AAB më 23 Qershor 2011.

OPERATIONAL ACTIVITIES

I. COOPERATION AND INITIATIVES

I. COOPERATION WITH IFC ON DEVELOPING THE ENERGY EFFICIENCY MARKET

AAB and IFC continue their good experience of cooperation in the development of Energy Efficiency market. The concrete agreement is that of adding to AAB's current website an "Energy Efficiency Loans Link" where detailed information shall be provided to the public. IFC shall provide all the necessary information to be posted on the website in consultation with AAB, both in Albanian and English. AAB shall be responsible for maintaining this link further on, and both parties shall cooperate for the launching of the web-link and related media coverage. This project fits with AAB's objective of improving the website and adding to its materials on Financial Education.

II. MEMORANDUM OF COOPERATION WITH THE MAGISTERIAL SCHOOL

In light of the difficulties banks are facing with enforcement of collateral, especially in the judicial processes, AAB committed to support the training of judges in order to better acknowledge and implement the legislation related to collateral execution.

In this framework AAB and representatives of AAB Legal Committee collaborated with the Magisterial School to add in their curricula for the coming year a special course on financial and banking products. AAB and the Magisterial School signed a memorandum of cooperation where agreed to organize two training seminars in Tirana during April – May 2012 and three regional activities with judges and prosecutor in other districts.

III. WORKING GROUP FOR CONVERGING WITH BASEL II STANDARD

Following the process of revising the existing Regulation "On the Capital Adequacy Ratio", aiming at bringing it closer to Basel II, BoA and AAB created a joint working group, with the participation of specialists from BoA and 6 member banks. In the first meeting of the working group in November 2011, members were acquainted with the concrete details of the project and established the arrangements for further meetings, especially emphasizing the necessary active participation of banks in the preliminary stage of drafting the amendments to the regulation, considering the fact that some banks have already been faced with this experience imposed by mother banks in the EU countries.



I. BASHKËPUNIM DHE INICIATIVA

I. BASHKËPUNIMI ME IFC PËR ZHVILLIMIN E TREGUT TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË

AAB dhe IFC vazhdojnë eksperiencën e tyre të mirë të bashkëpunimit për zhvillimin e tregut të efiçencës të energjisë. Marrëveshja konkrete është për shtimin e një “Linku për kredi për efiçencën e energjisë” në faqen e internetit të AAB, ku do të jepen informacione të detajuara për publikun. IFC do të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm që do të publikohet në faqen e internetit duke u konsultuar me AAB, në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht. AAB do të jetë përgjegjëse për të mirëmbajtur këtë link në vazhdim, dhe të dyja palët do të bashkëpunojnë për prezantimin e linkut në faqen e internetit dhe mbulimin përkatës në media. Ky projekt përputhet me objektivin e AAB për përmirësimin e faqes së internetit dhe shtimit të materialeve të saj mbi edukimin financiar.

II. MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Në kuadrin e vështirësive që bankat po hasin në zbatimin e kolateralit, sidomos në proceset gjyqësore, AAB mbështeti trajnimin e gjyqtarëve në mënyrë që të njihet dhe zbatohet legjisllacioni lidhur me ekzekutimin e kolateralit. AAB dhe përfaqësues të Komitetit Ligjor të AAB bashkëpunuan me shkollën e Magjistraturës për të shtuar në kurrikulën për vitin e ardhshëm një kurs të veçantë për produktet bankare. AAB dhe Shkolla e Magjistraturës firmosën një memorandum bashkëpunimi, për organizimin e dy seminareve në Tiranë gjatë periudhës Prill – Maj 2012 dhe organizimin e tre aktiviteteve rajonale me gjyqtarë dhe prokurorë në rrethe të tjera.

III. GRUPI I PUNËS PËR PËRPUTHJEN ME STANDARDIN BASEL II

Në vijim të procesit të rishikimit të Rregullores “Mbi normën e përshtatshmërisë së kapitalit”, që ka për qëllim qasjen me standardin Basel II, BSH dhe AAB krijuan një grup pune të përbashkët, me pjestarë specialistë nga Banka e Shqipërisë dhe 6 nga bankat anëtare. Në takimin e parë të grupit të punës në Nëntor 2011, anëtarët u njohën me detajet konkrete të projektit dhe vendosën për takimet e ardhshme, duke theksuar kryesisht pjesëmarrjen e nevojshme aktive të bankave në fazën paraprake të krijimit të draftit të amendamenteve të rregullores, duke konsideruar faktin që disa nga bankat janë përballur tashmë me këtë përvojë të imponuar nga bankat mëma në vendet Evropiane.



I. COOPERATION AND INITIATIVES (continued)

IV. COLLABORATION WITH THE AUSTRIAN DEVELOPMENT AGENCY (ADA)

AAB organized and participated in several meetings in the framework of the project "Support and Expansion of the Albanian Treasury System" (SETS) funded by the European Union and implemented by the Austrian Development Agency. AAB made an assessment of the technologies actually used from the banking system to codify tax bills, and of the most appropriate technology to be adopted by all banks in case a new coding system shall be introduced, and other technicalities of possible changes in the interface of banks with the Treasury of Ministry of Finance, and provided the information to all relevant parties. More technical meetings have followed where participants from banks.

V. CREATION OF A NEW TECHNICAL COMMITTEE AND TRAINING OPPORTUNITIES

Taking in consideration the increased efforts of AAB Secretariat in organizing trainings for member banks' staff and in order to coordinate with banks calendars for trainings for next year, AAB Secretariat organized a meeting with persons in charge of Human Resources Management in the member banks in November 2011. Following the discussions in this meeting, the AAB Assembly approved in its meeting of November the proposal of the Secretary General to establish an additional permanent technical committee, under the umbrella of AAB, namely the AAB Human Resources Committee. Its aim will be that of working mainly on evidencing the training needs of member banks' personnel and facilitating the organizing of trainings by AAB, but also in exchanging information regarding the best practices on human resources management in the banking sector.



Mrs. Najada XHAXHA
Chairwoman of the AAB
Payment System Committee

ALBANIAN PAYMENTS SYSTEMS TOWARD STANDARTIZATION

This is a very important project, both for financial policies and strategies of the Albanian Government as well as the development and adoption of the banking system in Albania. Inclusion of all active factors in building the right infrastructure and its professional realization is one of the aims of the AAB Payments Systems Committee. The project marks great values in its conception and the normal functioning of the processes involved, aiming to complete the full automation on collecting / distributing of the Government revenues / expenditures.

Meantime, this project will help in the minimization of the informal economy, the liquidity management, and will increase the possibilities on using the modern technology / alternative channels.

The selection of the encrypted system to be used shall be the challenge of this project and also the ambition of our Committee. The future vision and modernization will guide this process, which will be accompanied with reduced costs as long-term objectives.

I. BASHKËPUNIM DHE INICIATIVA (vazhdon)

IV. BASHKËPUNIMI ME AGJENCINË AUSTRIAKE PËR ZHVILLIM (ADA)

AAB organizoi dhe mori pjesë në një sërë takimesh në kuadër të projektit “Mbështetje dhe Zgjerim për Sistemin Shqiptar të Thesarit” (SETS) financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim. AAB bëri një vlerësim të teknologjisë që përdoret aktualisht nga sistemi bankar për të kodifikuar faturat e taksave, dhe të teknologjisë më të fundit që duhet të adaptohet nga të gjitha bankat në rast të prezantimit të një sistemi të ri kodifikimi, dhe të çështjeve të tjera teknike të ndryshimeve të mundshme në interface-in e bankave me Thesarin e Ministrisë së Financave, dhe ia përcolli këtë informacion të gjitha palëve përkatëse. Takime të tjera kanë vijuar me pjesëmarrës nga bankat.

V. KRIJIMI I NJË KOMITETI TË RI TEKNIK DHE MUNDËSIVE TË TRAJNIMIT

Duke marrë në konsideratë përpjekjet e Sekretariatit të AAB për organizimin e trajnimeve për stafin e bankave anëtare dhe në mënyrë që të bashkërendohet me kalendarin e bankave për trajnimet për vitin që vjen, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me përfaqësues të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nga bankat anëtare në nëntor 2011.

Në vazhdim të diskutimeve në këtë takim, Asambleja e AAB aprovoi në takimin e saj të nëntorit propozimin e Sekretares së Përgjithshme për të ngritur një komitet shtesë teknik të përhershëm, nën ombrellën e AAB, pikërisht Komitetin e Burimeve Njerëzore të AAB. Qëllimi i tij do të jetë kryesisht puna për të evidentuar nevojat për trajnim të personelit të bankave anëtare dhe lehtësimin e organizimit të trajnimeve nga AAB, gjithashtu edhe shkëmbimin e informacionit për sa i përket praktikave më të mira në menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin bankar.

SISTEMET E PAGESAVE SHQIPTARE DREJT STANDARTIZIMIT

Projekti në fjalë është i një rëndësie të madhe, si për politikën dhe strategjinë financiare të Qeverisë ashtu dhe në zhvillimin dhe përshtatjen e sistemit bankar në Shqipëri. Përfshirja e plotë e të gjithë faktorëve në ndërtimin e kësaj infrastrukture dhe realizimin e funksionimit të saj është një nga qëllimet e Komitetit të AAB-së për Sistemet e Pagesave. Projekti mbart vlera në konceptimin dhe funksionimin normal të proceseve të përfshira duke plotësuar kështu automatizimin e plotë të mbledhjes dhe shpërndarjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të Qeverisë.

Realizimi i këtij projekti do të ndihmonte në minimizimin e ekonomisë informale, menaxhimin më të mirë të likuiditeteve, dhe do të rriste mundësinë e përdorimit të kanaleve alternative bashkëkohore. Përzgjedhja e sistemeve të kodifikimit do të jetë sfida e këtij projekti dhe gjithashtu ambicia e këtij komiteti. Largpamësia dhe modernizimi do të drejtojnë këtë proces, të cilat përthehen në kosto të reduktuara si objektiva afatgjatë.





II. ADVOCACY AND SUPPORTING CAMPAIGNS

I. MEETING WITH THE CANDIDATE MAYOR OF TIRANA

On April 2011, Banks' Managers had a coffee-meeting with Mr. Lulzim Basha who was at the time Candidate for Mayor of Tirana. They discussed mainly on issues of common interest, considering the banking system as a very important factor and collaborator for the Municipality of Tirana, but also on the main concerns and challenges of banks activities in Tirana.

II. EU DELEGATION CONSULTATIVE MEETINGS

The EU Delegation organized during 2011 consultative meetings with EC officials and representatives of business operating in Albania, covering issues of enlargement, taxes, customs and industry concerns. AAB was represented at these meetings by the Secretary General and Operations Specialist that conveyed relevant issues of concern for banks.

III. MEETING WITH THE ADVISOR TO THE PRIME MINISTER

AAB Chairman, Secretary General and Legal Advisor had a meeting in December 2011 with the Advisor to the Prime Minister, also a Member of the Supervisory Council of BoA Mr Petraq Milo. AAB's representatives conveyed the main issues of concern to the banks such as: the collateral enforcement, the numerous blocking orders on taxpayers' accounts with banks with very short deadlines; concerns regarding BoA's regulations, in terms of the amount, methodology, and content of normative acts; and on the Deposits Insurance Premium and scheme.

IV. ON ENERGY EFFICIENCY

Taking in consideration recent developments in energy efficiency, AAB Secretariat has engaged in the involvement of its member banks in this market by supporting, participating and cooperating in organizing activities for the introduction of financial mechanisms to promote energy efficiency and identifying ways of mutual cooperation. In this context:

- In June 2011, IFC in cooperation with the National Agency of Natural Resources (AKBN) organized the seminar "On energy efficiency in buildings", with the participation of representatives of banks and AAB, KfW, GIZ, UNDP, and AKBN.
- In July 2011, AAB hosted a round table organized with the UNDP's Albanian Program for Market, where banks were presented with findings on the feasibility of financial mechanisms to promote solar power use for warm water.
- In September 2011, AAB Secretary General met with representatives of the European Union during their in-depth Review of the Energy Efficiency Policies and Programs of Albania under the Energy Charter Protocol on Energy Efficiency and Related Environmental Aspects (PEEREA), at AKBN.

V. ON FISCAL AMNESTY

In the framework of the Government's campaign on fiscal amnesty and capital legalization, AAB in addition to its support with legal expertise, sponsored an informative TV spot to inform the customers on the facilities offered by all banks in this process, which was broadcasted by five TV channels during July 2011.

II. PROMOVIMI DHE FUSHATAT MBËSHTETËSE

I. TAKIM ME KANDIDATIN PËR KRYETAR BASHKIE NË TIRANË

Në Prill 2011, Drejtues të bankave patën një takim joformal me Z. Lulzim Basha, në atë kohë kandidat për kryetar bashkie në Tiranë. Ata diskutuan kryesisht mbi çështje të interesit të përbashkët, duke e konsideruar sistemin bankar faktor shumë të rëndësishëm bashkëpunimi për Bashkinë e Tiranës, por gjithashtu edhe për shqetësimet kryesore dhe sfidat e aktivitetit të bankave në Tiranë.

II. TAKIME KONSULTIMI ME DELEGACIONIN E BE-SË

Delegacioni i BE organizoi gjatë vitit 2011 takime mes zyrtarëve të KE dhe përfaqësuesve të biznesit në Shqipëri, mbi çështje të taksave, detyrimeve doganore dhe shqetësime të tjera të sektorëve. AAB u përfaqësua në këto takime nga Sekretarja e Përgjithshme dhe Specialistja e Operacioneve, të cilat informuan mbi çështje shqetësuese për bankat.

III. TAKIM ME KËSHILLTARIN E KRYEMINISTRIT

Kryetari i AAB, Sekretarja e Përgjithshme dhe Këshilltarja ligjore patën një takim në dhjetor 2011 me Këshilltarin e Kryeministrit, njëkohësisht anëtar i Këshillit Mbikqyrës të BSH, Z. Petraq Milo. Përfaqësuesit e AAB transmetuan çështjet kryesore shqetësuese për bankat, si: ekzekutimi i kolateralit; urdhrat e shumta të bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesve me afate shumë të shkurtra; shqetësimin mbi rregulloret e BSH, për sa i përket numrit të madh të tyre metodologjisë, dhe përmbajtjes; dhe mbi primin dhe skemën e sigurimit të depozitave.

IV. MBI EFIÇENCËN E ENERGJISË

Nisur nga zhvillimet e fundit lidhur me efiçencën e energjisë, Sekretariati i AAB-së është angazhuar për përfshirjen e bankave në këtë treg duke mbështetur, marrë pjesë dhe organizuar aktivitete të prezantimit të mekanizmave financiarë që promovojnë efiçencën e energjisë dhe gjetjen e mënyrave të ndërsjellta të bashkëpunimit. Kështu:

- Në Qershor 2011 IFC, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) organizoi seminarin “Mbi efiçencën e energjisë në ndërtesa”, me pjesëmarrës përfaqësues të bankave dhe AAB, KFW, GIZ, UNDP, dhe AKBN.
- Në korrik 2011, AAB organizoi me Programin Shqiptar të UNDP-së për Tregjet, një tryezë të Rrumbullakët, ku iu prezantuan bankave disa konkluzione mbi realizueshmërinë e mekanizmave financiarë për promovimin e paneleve diellore për ujin e ngrrohtë.
- Në shtator 2011, Sekretarja e Përgjithshme e AAB takoi pranë AKBN-së përfaqësues të BE-së gjatë rishikimit nga ana e tyre të Politikave dhe Programeve të Efiçencës së Energjisë së Shqipërisë nën Protokollin e Energjisë mbi Efiçencën e Energjisë dhe aspekteve lidhur me mjedisin (PEEREA).

V. PËR AMNISTINË FISKALE

Në kuadër të fushatës së qeverisë për amnistinë fiskale dhe legalizimin e kapitalit, AAB përveç mbështetjes me ekspertizë ligjore, sponsorizoi një spot televiziv për të informuar klientët mbi lehtësitë e ofruara nga të gjitha bankat për këtë proces. Spoti u transmetua në pesë kanale televizive gjatë mujit korrik 2011



Workshop on Residential Energy Efficiency – Focus on Banks, IFC, June 2011
Seminar “Efiçenca e Energjisë – Fokus në Sistemin Bankar”, IFC, Qershor 2011



Round Table on Financial Mechanisms to Promote Solar Power for Warm Water in Albania, AAB and UNDP, Korrik 2011

Tryeza e Rrumbullakët mbi mekanizmat financiarë për promovimin e Energjisë Diellore për Ujë të Ngrrohtë në Shqipëri, AAB dhe UNDP, July 2011



Forumi i I-rë Kombëtar Shqiptar Kundër Mashtrimeve me Karta, Tiranë, 15 Prill 2011

First Albanian National Anti Fraud Forum, Tirana, 15 April 2011

III. WORKSHOPS & TRAININGS SEMINARS

I. ALBANIAN NATIONAL ANTI FRAUD FORUM

The Albanian National Anti Fraud Forum was organized by the Albanian Association of Banks and its Card Fraud Committee, on April 15th, 2011, at Sheraton Hotel, Tirana. It covered key industry developments from both technical and management, and fraud prevention and investigation perspectives. Participants were representatives of the Albanian commercial banks engaged in the cards business, employees of the State Police forces and Albanian Prosecution engaged in fighting against economic crime, as well as representatives from: OPDAT, BoA, partner companies Visa Cards International and MasterCard, Intesa Sanpaolo Card, the company Printec Albania, and representatives of the Kosovo Card Fraud Forum.

II. TBA TRAINING

The Turkish Banking Association organized a one week training seminar on "Banking and Finance" for 10 Albanian bankers, where all participants had the chance to extend their knowledge's on the topics such as: financial products, on IFRS standards, risk management and branch management, as well as were presented with facts and experiences on the development of Turkish banking sector after the financial crisis and the regulatory framework adopted.

III. ATM SECURITY AND PCI DSS TRAINING

AAB Secretariat in collaboration with LiquidNexus, a specialised and licensed training, education and consulting company focused on the payment and electronic card industry, organised a 3 days training course (1-3 November 2011) on the topics of ATM Security and PCI DSS. The training took place at AAB premises, and covered all aspects of protecting ATM's both physically and logically against attack, as well as compliance with standards designed for card payments systems. (Photos from the training)

IV. WORKSHOP ON MONEY REMITTANCES AND MONEY LAUNDERING

AAB in collaboration with the General Directory of Prevention of Money Laundering, and in the framework of the EU Twinning Project with this Directory, organized a Workshop for compliance officers regarding Money Remittances with the aim of analysing the operative typologies on ML risks. The Workshop was lectured by two EU Experts and participants were from Member banks, BoA and FIU. The Workshop took place from 25-27th of October 2011, at AAB premises.

III. SEMINARE DHE TRAJNIME

I. FORUMI SHQIPTAR KOMBËTAR KUNDËR MASHTRIMEVE

Forumi shqiptar kombëtar kundër mashtrimeve u organizua nga Shoqata Shqiptare e Bankave dhe Komiteti i luftës kundër mashtrimit me kartat, më 15 prill 2011, në Hotel Sheraton, në Tiranë. Ai mbuloi zhvillimet kyçe të industrisë nga ana teknike dhe menaxheriale, parandalimin e mashtrimeve dhe perspektivat e hetimit. Pjesëmarrësit ishin përfaqësues të bankave tregtare të Shqipërisë të angazhuar në biznesin e kartave, punonjës të forcave të policisë së shtetit dhe Prokurorisë Shqiptare të angazhuar në luftën kundër krimit ekonomik, si edhe përfaqësues nga: OPDAT, BSH, kompani partnere - Visa Cards International dhe MasterCard, Intesa Sanpaolo Card, kompania Printec Albania, dhe përfaqësues të Forumit të korrupsionit të kartave të Kosovës.

II. TRAJNIMI I TBA

Shoqata Turke e Bankave organizoi një seminar një javor mbi “Veprimet Bankare dhe Financat” për 10 bankierë shqiptarë, ku të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë të zgjeronin njohuritë e tyre në tema të tilla si: produkte financiare, standardet IFRS, menaxhimi i riskut dhe menaxhimit të degës, si dhe u prezantuan me fakte dhe përvoja nga zhvillimi i sektorit bankar Turk pas krizës financiare dhe kuadrin rregullues të adoptuar.

III. TRAJNIM MBI SIGURINË E ATM-VE DHE PCI DSS

Sekretariati i AAB-së në bashkëpunim me LiquidNexus, një kompani e specializuar dhe e licencuar për trajnime, mësimdhënie dhe konsultime e përqëndruar në industrinë e pagesave dhe kartave elektronike, organizuan një trajnim 3 ditor (1-3 nëntor 2011) mbi temat e Sigurisë së ATM dhe PCI DSS. Trajnimi u realizua në ambientet e AAB, dhe trajtoi gjitha aspektet e mbrojtjes fizike dhe logjistike të ATM-ve ndaj sulmeve. Gjithashtu, u trajtua edhe përputhshmëria me standardet ekzistuese mbi sistemet e pagesave me karta.

IV. SEMINAR PËR TRANSFERTAT DHE PASTRIMIN E PARAVE

AAB në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, dhe në kuadër të Projektit të Binjakëzimit me BE-në të kësaj Drejtorie, organizuan një seminar për oficerët e përputhshmërisë, në lidhje me transfertat me qëllim analizimin e tipologjive operacionale mbi rrezikun e pastrimit të parave. Seminari u drejtua nga dy ekspertë të BE-së dhe pjesëmarrësit ishin nga bankat anëtare, BSH dhe DPPPP. Seminari u zhvillua nga 25-27 tetor 2011, në ambientet e AAB-së.



ATM Security and PCI DSS Training, AAB, Tirana, November 2011

Trajnimi mbi Sigurinë e ATM-ve dhe PCI DSS, AAB, Tiranë, Nëntor 2011



IV. AAB PUBLICATIONS

I. ANNUAL REPORT

AAB Secretariat prepared the 2010 AAB Annual Report (as a bilingual publication) which was published and distributed by July 2011. The report included the AAB accounts for year 2010, which were audited by Credit Bank of Albania, and were submitted accordingly to the Tax authorities. Both English and Albanian versions are now posted on the AAB webpage. (Cover photo)

II. BANKIERI MAGAZINE

The BANKIERI project, as a quarterly magazine, was proposed from the AAB Secretariat to the General Assembly in its June meeting. The Editorial Board of the magazine is composed by the Executive Committee Members, the Secretary General, and four additional respectable personalities of the financial sector.

The AAB Operations Specialist in charge of the coordination for each issue keeps continuous contacts with the PR & Marketing Unit responsible staff of AAB Member banks in order to involve all them in this project for better promotion of the activities of the banking system. After a hard and intensive work, by end of October 2011 the first Edition of BANKIERI was printed and delivered to the banking community, all state institution, foreign organizations in Albania and abroad, media and other banking associations in the region, businesses and universities, etc.. Both Albanian and English versions of BANKIERI have been made available for the general public at the AAB

website, through a user friendly PDF reader tool. Two more issues of BANKIERI had been published and delivered while this report was being prepared. (Cover photo first number)

III. ANALYSES

